

Aneksi 1

I. Dënimet administrative dhe kompetencat për vendosjen e tyre

1. Për kundravajtjet administrative parashikohen:

a-dënime me gjobë;

i -mbajtja e proces verbalit të konstatimit të kundravajtjes administrative të përcaktuara në këtë vendim ose në ligje specifike

ii-marja e vendimit për dënim me gjobës pas konstatimit të saj

b-sekuestrimi dhe konfiskimi i sendeve;

2. Strukturat administrative të ngarkuara për konstatimin, shqyrtimin e secilës kundravajtjeve administrative janë

- Policia Bashkiake
- IVMT
- DAMT
- Drejtoria e Tatim Taksave dhe Menaxhimit të Aseteve.
- Drejtoria e Planifikimit të Territorit,
- Sektori i shërbimit publik,
- Njësitë Administrative,

Të cilët sipas rastit zbatojne vendosjen e gjobes sipas pikes 1, germa/ii, mbi bazen e aktit te konstatimit dhe shqyrtimit te tij sipas procedurave ne kete vendim.

3.Për cdo kundravajtje administrative organi administrativ vlerëson e zbaton formën me efikasitet të konstatimit, shqyrtimin e vendimit të dënimit administrativ

II. Procedurat e konstatimit dhe të shqyrtimit të kundravajtjes administrative

1. Proces verbalit i konstatimit tip1 në aneksin 3 të këtij vendimi;

a. mbahet në vendin e kryerjes së kundravajtjes, në kohën e konstatimit të saj në prani të palëve

b. nënshkruhet nga përpiluesi, kundravajtësi dhe dëshmitari i pranishëm;

c. në rastet kur kundravajtësi kundërshton të nënshkruajë në proces – verbal e konstatimit, ky fakt të evidentohet në proces-verbal

2. Vendosja e gjobës dokumentohet me formularin tip 2 (aneksi 3)

a.Vendimi i dënimit me gjobë merret nga organi administrativ që përcakton ky vendim sipas kundravajtjes së kryer.

b. Nënshkruhet nga organi administrativ që përcatohet në kundravajtje sipas aneksit 2 të këtij vendimi

c. Kundravajtësi njoftohet me shkrim për vendimin e dënimit me gjobë, e cila i njoftohet nëpërmjet shërbimit postar .

3. Proces verbali i konstatimit i mbajtur nga inspektorët e terrenit i dorëzohet brenda 24 orëve eprorëv në drejtoritë përkatëse , si struktura administrative që ky vendim ngarkon për vijim të procedurës.
4. Shqyrtimi dhe vendimi për kundravajtjet administrative hartohet:
 - a. Brenda 10 ditëve nga dita e depozitimit të proces- verbalit të konstatimit pranë strukturës administrative përkatës,përvec rasteve të përcaktuara në ligjet specifike
 - b. Shqyrtimi bëhet në prani të kundravajtësit, shqyrtimi mund të bëhet në mungesë, kur kundravajtësi ka marrë dënimin, dhe nuk ka shkaqe justifikuese për mosparaqitje.
 - c. Vendimi për kundravajtjet administrative të plotësohet me të gjitha të dhënat sipas formatit të miratuar formulari tip 2 në aneksin 3 të këtij vendimi
 - d. kur organi administrativ për shqyrtimin e kundravajtjes administrative konstaton shkaktimin e dëmit si pasojë e kundravajtjes pas përfundimit të shqyrtimit administrativ vlerëson edhe masën e dëmit me vendim sipas formularit tip 2 në aneksin 3.
 - e. Vendimi së bashku me kopje të proces- verbalit të konstatimit, i njoftohen kundravajtësit direkt ose nëpërmjet postës brenda 48 orëve nga marja e tij.
5. Sekuestrimi apo konfiskimi i sendeve për kundravajtje administrative bëhet nëpërmjet mbajtjes së proces- verbalit tip ku:
 - a.Mbahet në vendin e kryerjes së kundravajtjes dhe në kohën e konstatimit të saj në prani të kundravajtësit dhe të dëshmitareve të pranishëm.
 - b.Nënshkruhet nga përpiluesi, kundravajtësi, dëshmitarët e pranishëm.
 - c.Në rastet ku kundravajtësi kundërshton nënshkrimin e proces- verbalit ky fakt evidentohet në proces verbal.
 - d. I bashkangjitet inventarit tip për materialet e konfiskuara.
6. Për sendet e konfiskuara ose sekuestruara veprohet si më poshtë:
 - a.Për kundravajtjet e parashikuara në këtë vendim si dhe të gjitha produktet e tjera ushqimore dhe fruta perime të bëhet asgjësimi sipas dispozitave ligjore për ruajtje e shëndetit publik.
 - b.Për të gjitha sendet e konfiskuara ose sekuestruara të tjera të kalojnë për ruajtjen pranë ambienteve të caktuara për këtë qëllim sipas fletës së inventarit të konfiskimit. Materialet që kanë vlere të shiten në ankant dhe të ardhurat nga procesi i shitjes në ankant të kalojnë në buxhetin e Bashkisë.

III. Ankimim për dënimet administrative

- 1.Kundër vendimit për kundravajtjet administrative të nxjerre nga struktura administrative përkatëse mund të bëhet ankimi pranë Kryetarit të Bashkisë brenda 10 ditëve nga data e marrjes se tij.
- 2.Ankimimi administrativ pezullon ekzekutimin e vendimit të parë, deri në momentin që merret vendimi përfundimtar për kundravajtjet e shprehura në këtë vendim, përvec rasteve të përcaktuara në ligjet specifike
- 3.Kryetari brenda 10 diteve nga marja e ankimit shqyrton ankimin dhe merr vendim përfundimtar për kundravajtjet administrative.
- 4.Vendimi për kundravajtjet administrative fillon e efektet ligjore për ekzekutimin e tij në momentin e marrjes së njoftimit për vendimin përfundimtar
5. Vendimi për kundravajtjet administrative nuk mund të ankimohet në rrugë gjyqësore pa konsumuar të drejtën e ankimit në rrugë administrative

6.Kur dënimet administrative vendosen të mbështetura në ligje të vecanta specifike sipas përcaktimeve të këtij vendimi për shkeljet që përbejnë kundravajtje administrative dhe sanksionet përkatëse, zbatohen procedurat e afatit të ankimimit të parashikuara në ligjin përkatës.

IV . Ekzekutimi i vendimeve administrative

1.Procedura e ekzekutimit të vendimeve për kundravajtje administrative të parashikuara në këtë vendim ndiqet nga struktura administrative që e ka hartuar atë.

2.Të gjitha vendimet e dënimit me gjobë ndiqen nga drejtoria e të ardhurave dhe drejtoria e financave për arketimin e shumave të përcaktuara në vendime.

3.Kur arkëtimi i gjobës bëhet i pa mundur zbatohen procedurat e mbledhjes me forcë të detyrimeve.

4..Organet administrative dokumentojnë dhe evidentojnë në regjistër të vecante gjobat e vendosura dhe arkëtimin tyre, të cilat i rakordojnë me drejtorinë e Financës.

5..Kur për dënimet administrative mbyllje apo pezullim aktiviteti, sekuestrim të mallrave apo materiale bëhet i pa mundur ekzekutimi i vendimit nga organi administrativ kërkohet ekzekutim nga Policia Bashkiake.

5.1.Kryetarit të Bashkisë i paraqitet kërkesa e argumentuar për ekzekutimin e vendimit të kundravajtjes administrative nga Policia Bashkiake.

5.2 Kërkesa me shënimet urdhëruese të Kryetarit të Bashkisë i kalon për veprim Policisë Bashkiake.

5.3 Policia Bashkiake bashkë me organin administrativ programon dhe përcakton veprimet si dhe personat për zbatimin e dënimit administrativ forcërisht.

5.4 Policia bashkiake garanton zbatimin e urdhërit të Kryetarit të Bashkisë për ekzekutimin forcërisht të vendimeve për kundravajtjet administrative të parashikuara në këtë vendimin

V-Arketimi i gjobave dhe detyrimeve

1.Gjoha dhe shumat që duhet të paguhen sipas vendimit për kundravajtjet administrative paguhen nga kundravajtësi brenda 10 ditëve nga data kur është njoftuar për vendimin e dënimit me gjobë

2.Pas kalimit të këtij afati për cdo ditë vonese paguajnë kamat 1 % në ditë të masës së gjobës por jo me shumë se 30 ditë.

3. Procedura e arkëtitimit realizohet në drejtimin e strukturës që ka hartuar vendimin e gjobës. Kur kjo menyrë bëhet e pa mundur zbatohen procedurat e përgjithshme të arkëtitimit.

4.Arkëtimi i gjobave bëhet në cdo bankë ne arkat e rajoneve ose ne arkën e bashkisë Ura Vajgurore.

a.arkëtimi i gjobave në banke bëhet nga subjekti ,pas marrjes së faturës për arkëtim (për pagesa në Bankë).

b.kundravajtësi paraqitet në arkë me vendimin e gjobës për të kryer pagesën.

c.arkëtimi në arkë bëhet sipas vendimit të gjobës të paraqitur nga subjekti.Subjektit detyrimisht i jepet kopja e arkëtitimit me përshkrim të plotë për dokumentin dhe objektin e arketimit.

5.Kur për rrethana financiare subjekti nuk mund të paguaj plotësisht ose në afat, mund të lidhet marrëveshje për pagesë me këste.

a.Kërkesa ,me shkrim i drejtohet Kryetarit të Bashkisë nga subjekti;

b.Marrëveshja nuk mund të parashikojë afate me shumë se 6 muaj nga data e nënshkrimit

c.Mospagesa e një kësti në afat, zgjidh automatikisht marrëveshjen dhe për pjesën e mbetur të detyrimit zbatohen procedurat si për cdo detyrim të ri.

VI-Mbledhja me forcë e detyrimit

1.Kur subjekti nuk paguan gjobën brenda afateve të përcaktuara zbatohen procedurat e mbledhjes me forcë të detyrimit.

2.Për zbatimin e procedurave të mbledhjes me forcë të detyrimit dhe zbatimin e urdhrimit të ekzekutimit të caktuar në kreun V, të ligjit për kundravajtje administrative nenet 30 e në vijim nga zyra juridike .

3.Organi administrativ që ka vendosur gjobën, pasi ka zbatuar të gjitha procedurat për arkëtim vullnetarisht i paraqet zyres juridike propozimin për mbledhjen forcërisht të detyrimit shoqëruar me dokumentacionin dhe të dhenat përkatëse.

4-Zyra Juridike pasi vlerëson zbatimin e procedurave të kryera e plotësim dokumentacioni fillon zbatimin e procedurave për mbledhjen me forcë të detyrimit.

a.Përgatit e nis kërkesen në gjykatë për nxjerrjen e urdhërimit të ekzekutimit të titullit

b.Urdhërin e Kryetarit për vënien në zbatim të urdhërimit të ekzekutimit ku përcaktohen detyrat që ngarkohen, personat e ngarkuar dhe detyrimisht një përfaqësues i organit administrativ përkatës, njoftimi urdhruar për policinë bashkiake për sigurimin e zbatimit të urdhërimit.

c.Përgatit urdhërin e sekuestrimit format tip.

5.Personat e ngarkuar për sekuestrimin e pasurisë kontaktojnë me subjektin e bëjnë të qartë qëllimin e ardhjes dhe kërkojnë vullnetarisht pagimin e gjobës para se të vihet dorë në pasurinë e tij.

6.Kur shikohet e justifikueshme kërkesa e subjektit personat e ngarkuar me urdhër mund ta shtyjnë ekzekutimin deri në 5 ditë, veprim i cili dokumentohet.

Aneksi 2

Kundravajtje administrative dhe sanksionet përkatëse si më poshtë:

I. Kundravajtje Administrative për ndërhyrjet dhe dëmtimet në hapësirat dhe pronat publike dhe pyjet:

1.Dëmtimi i kontinereve ose bazamenteve të kontinereve të mbetjeve urbane, lëvizja e tyre nga vendet e përcaktuara përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë 10 000 lekë.

Ngarkohet Policia Bashkiake dhe administratorët

2.Dëmtimi i rrjetit të ndricimit publik , kablo, shtylla ndricimi rrugor, ndricuesat etj përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë minimalisht 10.000 lekë për çdo konstatim, kurse per shtyllat ,ndricuesat c'demtimi do të kryhet me vleren e shtylles referuar dokumentacionit të vendosjes së tyre

Ngarkohet Policia Bashkiake dhe Sektori I Shërbimit Publik.

3.Hedhja e inerteve dhe materialeve të ndërtimit gjatë kryerjes së punimeve në vënde të paparashikuara në kontratë duke shkaktuar bllokim rrugësh, grumbullim mbetjesh dhe ndotje të ambjentit përreth. Mosrikthimi i ambjentit në gjëndjen e mëparshme përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë 10 000 lekë, për cdo konstatim.

Ngarkohet IVMT , Policia Bashkiake, administratorët

4.Dëmtimi i rrugëve të shtruara me asfalt, kalldrëm, me stabilizant, i trotuareve përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë 10.000 lekë per çdo konstatim.

Ngarkohet Policia Bashkiake, administratorët dhe Sektori I Shërbimit Publik

5 Bllokimi i rrugëve, trotuareve dhe kunetave me materiale inerte, beton etj përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë 10.000 lekë për cdo konstatim.

Ngarkohet Policia Bashkiake ,Sektori I Shërbimit Publik, Administratorët

6.Dëmtimi i bankinave të kanaleve të ujërave të bardha , i pusetave të ujërave të bardha ,zgarave, te bankinave të rrugëve dhe të përrenjve, kanaleve vaditëse e kulluese, ndërhyrje dhe prishje të strukturave të digave dhe aksesoreve, të veprave të artit në to, të përcaktuara në hartografi, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 10.000 lekë deri në vlerën e riparimit të dëmit apo aksesorit të dëmtuar.

Ngarkohet DAMF , IVMT dhe Policia bashkiake

7.Hedhja e dherave dhe mbeturinave ne rrugë, trotuare dhe në kanalet e ujërave të bardha përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë 10.000 lekë për cdo konstatim.

Ngarkohet DAMF , IVMT, administratorët dhe Policia bashkiake

8.Dëmtimi i tabelave të sinjalistikës rrugore dhe atyre orientuese përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë 10.000 lekë per çdo konstatim.

Ngarkohet Policia Bashkiake, IVMT

9.Dëmtimi i hapësirave publike të gjelbërta, drurëve , shkurreve dekorative dhe cdo brezi të gjelbër përbën kundravajtje administrative dhe dënohet me gjobë 10.000 lekë , për pemët me lartësi mbi 5m vlera do të jetë 15000 lekë.

Ngarkohet Policia Bashkiake

10.Rrethimi I pjesëve të pyllit apo tokës pyjore pa lejen e organeve të shërbimit pyjor përbën kundravajtje administrative dhe dënohet me gjobë 5000 lekë.

Ngarkohet Specialisti i mbrojtjes se Pyjeve

11.Hedhja e mbetjeve urbane dhe inerte Brenda në pyll ose në token pyjore jashtë vendeve të caktuara përbën kundravajtje administrative dhe dënohet me gjobë 10 000 lekë.

Ngarkohet Specialisti i mbrojtjes se Pyjeve

12.Transporti I materialit drusor nga pylli për në qëndrat e përpunimit apo shitjes pa shoqëruar me leje transporti përbën kundravajtje administrative dhe dënohet me gjobë 15 000 lekë dhe sekuestrim malli.

Ngarkohet Specialisti i mbrojtjes se Pyjeve

13.Ngritja e ndërtimeve të thjeshta, gardhe e kampingje Brenda fondit pyjor përbën kundravajtje administrative dhe dënohet me gjobë 5000 lekë.

Ngarkohet Specialisti i mbrojtjes se Pyjeve

14.Kullotja e bagëtive në fondin pyjor, në pyjet e reja ,në pyllëzime përbën kundravajtje administrative dhe dënohet me gjobë 5000 lekë.

Ngarkohet Specialisti i mbrojtjes se Pyjeve

15.Përdorimi I paligjshëm I fondit pyjor dhe tokës pyjore, përbën kundravajtje administrative dhe dënohet me gjobë 10 000 lekë.

Ngarkohet Specialisti i mbrojtjes se Pyjeve

16. Dëmtimi nga pakujdesia I pyjeve, tokës pyjore dhe pyjeve të reja përbën kundravajtje administrative dhe dënohet me gjobë 10 000 lekë.

Ngarkohet Specialisti i mbrojtjes se Pyjeve

17.Prerja pa leje ose dëmtimi me dashje I pyjeve ,I tokës pyjore, I pyjeve të reja përbën kundravajtje administrative dhe dënohet me gjobë 10 000 lekë.

Ngarkohet Specialisti i mbrojtjes se Pyjeve

18. Hedhja e inerteve në lum përbën kundravajtje administrative dhe dënohet me gjobë 10 000 lekë, për familjaret dhe 20 000 lekë për bizneset.

Ngarkohet IVMT dhe Policia Bashkiake

19. Hapja e rrugëve pa leje nga organet kompetente, mosrikthimi i ambjentit në gjëndje të mëparshme përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë 10.000 lekë, për cdo konstatim.

Ngarkohet DAMF , IVMT dhe policia bashkiake

II. Kundërvajtjet administrative në fushën e mjedisit:

1.Përpunimi apo djegia e mbeturinave të ndryshme urbane jashtë vendeve të përcaktuara nga Bashkia përbën kundravajtje administrative dhe dënohet me gjobë 5000 lekë.

Ngarkohet DAMF , IVMT dhe Policia bashkiake

2. Hedhja e mbeturinave jashtë vendeve të përcaktuara nga Bashkia si dhe nxjerrja në rrugë apo kanal in ujërave të zeza dhe të bardha ose ujërave stallore përbën kundervajtje administrative dhe dënohet me gjobë 5 000 lekë për qytetarët, 10 000 lekë për njësitë e tregëtimit me shumicë dhe pakicë.

Ngarkohet DAMF , IVMT dhe Policia bashkiake

3. Hedhja e mbetjeve të ndërtimit, mbetjeve të gjelbërimit, mbetjeve të vëllimshme në pikat e grumbullimit të mbetjeve urbane ose në ambiente publike përbën kundervajtje administrative dhe dënohet me gjobë 5000 lekë.

Ngarkohet DAMF , IVMT dhe Policia bashkiake

4. Nxjerrja e plehut të bagëtive në rrugë kryesore apo rrugë lagje përbën kundervajtje administrative dhe dënohet me gjobë 5000 lekë.

Ngarkohet DAMF , IVMT dhe Policia bashkiake

ake

5. Derdhja e ujërave të zeza , ujrave të bardha, ujerat e zeza te bagëtive në rrugë ose kanale, përbën kundervajtje administrative dhe dënohet me gjobë 5000 lekë.

Ngarkohet DAMF , IVMT dhe Policia bashkiake

6. Ndotja nga karrierat e gurit gëlqeror si rezultat I mospërdorimit të impiantit të ujit në karrierë përbën kundervajtje administrative dhe dënohet me gjobë 10 000 lekë. per cdo konstatim

Ngarkohet DAMF , IVMT dhe Policia bashkiake

7. Ndotja e vendstrehimeve me mbetje te ngurta nga qytetare apo subjekte private, përbën kundervajtje administrative dhe dënohet me gjobë 10.000 lekë për cdo rast konstatimi.

Ngarkohet DAMF , IVMT , policia bashkiake administratorët

8. Zënia e kanaleve kullues e vaditës me prita me materiale të ndryshme, hedhja e inerteve në kanal , si dhe hedhja mbeturinave bimore (perime dhe drufrutorë) gjatë dhe pas përfundimit të vjeljes së prodhimit përbën kundervajtje administrative dhe dënohet me gjobë 10.000 lekë për çdo konstatim.

Ngarkohet DAMF , IVMT dhe Policia bashkiake

III. Kundervajtje Administrative në fushën e Bujqësisë:

1. Cdo zënie e dëmtim i tokës bujqësore përbën kundervajtje administrative dhe dënohet me gjobë (10.000) leke.

Ngarkohet DAMF , IVMT dhe Policia bashkiake

2. Lejimi i fillimit të punimeve ndërtimore e të punimeve të tjera të kundërligjshme që ndryshojnë destinacionin e tokës bujqësore, përbën kundervajtje administrative dhe dënohet me gjobë (10.000) leke.

Ngarkohet DAMF , IVMT dhe Policia bashkiake

3. Ndërtimi dhe shfrytëzim karriere për material dhe lëndë të tjera inerte përgjatë rrjedhës së lumenjve kur në të dyja anët ose njëra anë e bregut të lumit kufizohet drejtpërdrejt me tokë bujqësore , përbën kundervajtje administrative dhe dënohet me gjobë (5000) leke.

Ngarkohet DAMF , IVMT dhe Policia bashkiake

4. Depozitimi mbi dhe nën sipërfaqen e tokës bujqësore të mbetjeve të çfarëdo lloji, që dëmtojnë pjellorinë e tokës bujqësore, përbën kundervajtje administrative dhe dënohet me gjobë (5000) leke.

Ngarkohet DAMF , IVMT dhe Policia bashkiake

5. Mosmirëmbajtja dhe mospërdorimi brenda territorit të tokës bujqësore nga pronarët dhe posedues të tjerë të ligjshëm të rrjetit të kullimit ,sistemit të ujitjes ,të veprave të artit të cilat shkaktojnë moçalizimin,kënetëzimin,rikripëzimin e tokave bujqësore , përbën kundervajtje administrative dhe dënohet me gjobë (5.000) leke.

Ngarkohet DAMF , IVMT dhe Policia bashkiake

6.Ndryshim I destinacionit të tokës bujqësore, përbën kundravajtje administrative dhe dënohet me gjobë 10 000 lekë.

Ngarkohet DAMF , IVMT dhe Policia bashkiake

7.Depozitimi I lëndëve të ngurta ose të dëmshme mbi sipërfaqen e tokës bujqësore, përbën kundravajtje administrative dhe dënohet me dënohet me gjobë 5 000 lekë.

Ngarkohet DAMF , IVMT dhe Policia bashkiake

IV.Kundravajtje Administrative ne fushen Veterinare dhe mbrojtjes se konsumatoreve:

1. Therja e kafshëve jashtë thertores përbën kundravajtje administrative dhe dënohet me gjobë 10.000 lekë . Në rast përsëritje bëhet sekuestrimi i mishit.

Ngarkohet Specialisti i sherbimit veterinar

2.Dalja e mishit nga thertorja pa vulosur dhe pa çertifikatë shëndetësore veterinare përbën kundravajtje administrative dhe dënohet me gjobë 10.000 lekë . Në rast përsëritje bëhet sekuestrimi i mishit.

Ngarkohet Specialisti i sherbimit veterinar

3.Shitja e mishit të pakontrolluar (pa vulën dhe çertifikatën veterinare) në dyqan përbën kundravajtje administrative dhe dënohet me gjobë 10 000 lekë. Në rast përsëritje bëhet mbyllja e aktivitetit.

Ngarkohet Specialisti i sherbimit veterinar

4.Mos plotësimi i kushteve higjeno-veterinare në dyqanet e mishit dhe tregje përbën kundravajtje administrative dhe dënohet me gjobë 10.000 lekë . Në rast përsëritje bëhet mbyllja e aktivitetit.

Ngarkohet Specialisti i sherbimit veterinar

5.Futja e kafshëve në treg pa çertifikatë lëvizëse veterinare përbën kundravajtje administrative dhe dënohet me gjobë 5000 lekë.

Ngarkohet Specialisti i sherbimit veterinar

6.Mos plotësimi i kushteve higjeno-veterinare në tregun e kafshëve përbën kundravajtje administrative dhe dënohet me gjobë 10.000 - 20.000 lekë . Në rast përsëritje bëhet mbyllja e aktivitetit deri në plotësimin e kushteve.

Ngarkohet Specialisti i sherbimit veterinar

7.Mbajtja dhe lëvizja në hapësirat e qarkullimit publik të kafshëve të luksit si qenë, ari etj pa masa mbrojtëse përbën kundravajtje administrative dhe dënohet me 2000 lekë gjobë.

Ngarkohet Specialisti i sherbimit veterinar

8.Zënia e kanaleve kullues e vaditës me prita me materiale të ndryshme, hedhja e inerteve në kanal , si dhe hedhja mbeturinave bimore (perime dhe drufrutorë) gjatë dhe pas përfundimit të vjeljes së prodhimit përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë 10.000 lekë për çdo konstatim.

9.Mbajtja e kafshëve shtëpiake (dhën, dhi, derra , gjedh etj) në afërsi të qëndrave të banuara kur ndotin ambjentin dhe ka ankesa nga qytetaret përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë 3000 lekë.

Ngarkohet Specialisti i sherbimit veterinar

10.Shitja e të gjitha produkteve me origjinë shtazore pa certifikatën shëndetësore dhe veterinare si dhe kur ka kaluar data e skadencës përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë 5000 lekë.

Ngarkohet Specialisti i sherbimit veterinar

11.Mos pagimi I tarifës veterinare (taks-therje, certificate shëndetësore veterinare) në afatin e caktuar përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë 5000lekë Në rast përsëritje bëhet bllokimi I aktivitetit.

Ngarkohet Specialisti i sherbimit veterinar dhe policia bashkiake

11.Shitja e produkteve dhe nën produkteve shtazore dhe blegtorale në njësi tregëtare të pamiratuara nga institucionet shtetërore përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë 5000lekë .

Ngarkohet Specialisti i sherbimit veterinar dhe policia bashkiake

12.Shitja e peshkut, mishit, vezëve,qumështit, djathi t dhe çdo produkti tjetër blegtoral në rrugë dhe hapësira të tjera publike përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë 5000 lekë.

Ngarkohet Specialisti i sherbimit veterinar dhe policia bashkiake

13.Shitja e peshkut pa certificate shëndetësore veterinare, pa mjet frigoriferik, në mjete të zakonshme, govata, plasmas, arka, kova etj, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë 5000 lekë.

Ngarkohet Specialisti i sherbimit veterinar dhe policia bashkiake

V. Kundërvajtjet administrative në fushën e planifikimit dhe kontrollit të territorit:

1. Hedhja e mbeturinave nga lartësia e objekteve ne proces ndërtimi pa zbatuar rregullat e punimeve te ndërtimit , përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë 10 000 lekë. Në rast përsëritje bëhet pezullimi i punimeve.

Ngarkohet IVMT

2. Mungesa e paisjeve të larjes, pompa uji (lavazho), në dalje të kantierit te cilat shërbejnë për larjen e gomave të mjeteve si dhe të gjitha pjesëve të jashtme te cilat shkaktojnë ndotje të mjedisit, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë 10 000 lekë. Në rast përsëritje bëhet pezullimi i punimeve.

Ngarkohet IVMT

3. Ndotja e hapësirave publike nga makinerite e ndryshme të ndërtimit, nëpërmjet rrjedhjes së materialeve të ndërtimit, gomave te pa pastruara etj, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë 10 000 lekë. Në rast përsëritje bëhet pezullimi i punimeve.

Ngarkohet IVMT, Policia Bashkiake

4. Transportimi nga kamionet e tonazhit të rëndë i materialeve ndërtimore pa mbulesë apo masa mbrojtëse, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë 10 000 lekë për cdo rast.

Ngarkohet IVMT, Policia Bashkiake

5. Mungesa e mjeteve mbrojtëse në objekt, të cilat shërbejnë për evitimin e ndotjes së ambientit nga pluhurat, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë 10 000 lekë. Në rast përsëritje bëhet pezullimi i ndërtimeve.

Ngarkohet IVMT, Policia Bashkiake

VI.Kundravajtje Administrative për kryerje veprimtarish pa leje apo autorizim përkatës:

1.Ushtrimi i veprimtarive pa leje nga Bashkia, për aktivitete sipas Vendimeve të Këshillit të Bashkisë Ura Vajgurore, si servis automjetesh, shërbime lavazho parkime, gomisteri, zdrukthari, prodhim/përpunim inerte e të ngjashme me to, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë 10 000 lekë. Për rast të përsëritura mbyllet aktiviteti.

Ngarkohet Policia Bashkiake dhe Drejtoria e Tatim Taksave dhe Menaxhimit të Aseteve.

2.Tregëtimi i karburanteve për automjete (nga stacionet e shitjes së karburanteve) dhe i lëndëve djegëse (nga njësitë e shitjes së lëndëve djegëse, bombula gazi etj) pa autorizim nga Bashkia, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë 10 000 lekë. Për rast përsëritje mbyllet aktiviteti.

Ngarkohet Policia Bashkiake dhe Drejtoria e të Ardhurave dhe asetëve

3.Ushtrim aktiviteti pa license, pa çertifikatë, apo autorizim të lëshuar nga Bashkia përbën kundërvajtje administrative dhe për;

Autoveture [4+1 deri në 9+1 vende] - denohet me gjobe 16.000 lekë

Autobuze - denohet me gjobe 18 000 lekë

Mjete tonazhi të rëndë - denohet me gjobe 20 000 lekë

Ngarkohet Policia Bashkiake dhe Drejtoria e Tatim Taksave dhe Menaxhimit të Aseteve, dhe Sp i Transportit

4. Kalimi i afatit për nxjerrjen e licensës , çertifikates , autorizimit të lëshuar nga Bashkia përbën kundërvajtje administrative dhe;

- për persona fizik dënohet me gjobë 5 000 lekë

- për persona juridik dënohet me gjobë 5 000 lekë

Ngarkohet Policia Bashkiake dhe Drejtoria e Tatim Taksave dhe Menaxhimit të Aseteve, dhe Sp i Transportit

5. Qëndrimi i mjeteve të pautorizuara në vëndqëndrimet e shërbimit të transportit publik të caktuara nga bashkia, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë 5000 lekë.

Ngarkohet Policia Bashkiake

6. Shitja e ujit për konsum publik me mjet autobot pa lejen e mjetit nga Drejtoria e Higjenës përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë 5000 lekë.

Ngarkohet Drejtoria e Tatim Taksave dhe Menaxhimit të Aseteve si dhe Policia Bashkiake

7. Shitja e ujit për konsum publik me mjet autobot pa shoqëruar me fletë analize nga Drejtoria e Higjenës përbën kundravajtje administrative dhe dënohet me gjobë 5000 lekë.

Ngarkohet Drejtoria e Tatim Taksave dhe Menaxhimit të Aseteve si dhe Policia Bashkiake

VI. Të përgjithshme

1. Për Kundërvajtje Administrative të parashikuara në këtë vendim, të cilat janë të parashikuara në ligje të veçanta, zbatohen kundërvajtjet administrative të përcaktuara në ligj, sipas masave dhe gjobave që përcakton ligji i posacëm.
2. Kundravajtjet e konstatuara në cdo rast të shoqërohen me prova shkresore (si foto, filmime etj)
3. Kundravajtjet administrative në fushën e zbatimit të punimeve të ndërtimit i nënshtrohen sanksioneve në ligjin specifik.
4. Me ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Ekzekutivi i Bashkisë dhe strukturat përkatëse të caktuar në këtë vendim

Aneks nr 3

Përcaktimi dhe masa e dënimit gjobës të kundërvajtjeve të përcaktuara në “Rregulloren për kushtet dhe rregullat e zënies së hapësirës publike në bashkinë Urë Vajgurore ” të miratuar me vendimin nr 53 date 24/12/2019, të k. Bashkiak dhe ndryshimet e miratuara me VKB NR 72 DATE 02.12.2020

A- Masat e sanksionimit me gjobë për kundërvajtjet administrative të parashikuara në nenin 10 të kësaj rregullore :

1. Për kundërvajtjen *Zënia e hapësirave publike pa u pajisur më parë me lejen përkatëse; Policia Bashkiake vendosë gjobë nga 1 000 (një mijë) deri në 20000(njëzetmijë) lekë*
2. Për kundërvajtjen *Ushtrimi i aktivitetit në një hapësirë më të madhe se ajo e përcaktuar në lejen që i është dhënë; Policia Bashkiake vendosë gjobë nga 1 000 (një mijë) deri në 10000(dhjetemijë) lekë*
3. Për kundërvajtjen *Instalimi i pajisjeve për të cilat nuk ka marrë lejen përkatëse Policia Bashkiake vendosë gjobë nga 5 000 (një mijë) deri në 20000(njëzetmijë) lekë*
4. Për kundërvajtjen *mosmirëmbajtja e pajisjeve dëmton/cenon dekorin e qytetit ose përbën rrezik për jetën e qytetarëve Policia Bashkiake vendosë gjobë nga 5 000 (një mijë) deri në 20000(njëzetmijë) lekë*
5. Për kundërvajtjen *Subjekti nuk mban pastër hapësirën e cila i është lënë në dispozicion; Policia Bashkiake vendosë gjobë nga 1 000 (një mijë) deri në 10000(dhjetemijë) lekë*
6. Për kundërvajtjen *Subjekti nuk paguan tarifën për zënieën e hapësirës publike brenda afateve të përcaktuara në leje Policia Bashkiake vendosë gjobë nga 5 000 (një mijë) deri në 20000(njëzetmijë) lekë*
7. Për kundërvajtjen *Subjekti prish qetësinë publike apo ka sjellje të padenjë; Policia Bashkiake vendosë gjobë nga 1 000 (një mijë) deri në 20000(njëzetmijë) lekë*
8. Për kundërvajtjen *Vazhdimi i aktivitetit edhe pas mbarimit të afatit të përcaktuar në leje apo anulimit;; Policia Bashkiake vendosë gjobë nga 1 000 (një mijë) deri në 20000(njëzetmijë) lekë*
9. Për kundërvajtjen *zënia e kryer nuk është në përputhje me kriteret që janë përcaktuar në lejen e dhënë si edhe në ato raste kur shkeljet mund të jenë të ndryshme dhe të sanksionuara në akte të tjera ligjore, nënligjore dhe rregullatore në fuqi Policia Bashkiake vendosë gjobë në konsultim me ligjin përkatës ,por në asnjë rast jo më pak se 10000 (dhjetëmijë) leke*
10. Për kundërvajtjen *Dëmtimi i muraleve të qytetit të Urës Vajgurore Policia Bashkiake vendosë gjobë nga 5 000 (një mijë) deri në 20000(njëzetmijë) lekë*
11. Për kundërvajtjen *Ndërhyrjet në fasadat e pallateve apo banesave kolektive Policia Bashkiake vendosë gjobë nga 5 000 (një mijë) deri në 20000(njëzetmijë) lekë , kur vlera e dëmit është më e madhe se 20000(njëzetmijë) leke gjoba do të jetë e barabartë me vlerën e c’ demtimit.*
12. Për kundërvajtjen *kalimin me mjete në hapësirat publike të destinuara për këmbësore, Policia Bashkiake vendosë gjobë*

1.Për motocikleta	5 000 Lekë
2.Për autovetura	10 000 Lekë
3.Për mjete te tjera transporti	15 000 Lekë

B- Masat e sanksionimit me gjobë për kundërvajtjet administrative të parashikuara në nenin 39 të kësaj rregullore janë:

1. Për kundërvajtjen *Zënia e hapësirave publike më shumë se 4 m², me përjashtim të rulotave pa u pajisur me lejen përkatëse*; **Policia Bashkiake vendosë gjobë nga 1 000 (një mijë) deri në 20000(njëzetmijë) lekë**
2. Për kundërvajtjen *shkelje e pikës b) të nenit 39* **Policia Bashkiake vendosë gjobë nga 1 000 (një mijë) deri në 20000(njëzetmijë) lekë**
3. Për kundërvajtjen *shkelje e pikës c) të nenit 39* **Policia Bashkiake vendosë gjobë nga 1 000 (një mijë) deri në 20000(njëzetmijë) lekë**
4. Për kundërvajtjen *njësitë e shitjes ambulatorë që tregtojnë produkte ushqimore të përpunuara në një venddhodhje të caktuar ku në një rreze prej më pak se 30 m ekziston një bar, restorant, fast-food apo dyqan fruta-perimesh*; **Policia Bashkiake vendosë gjobë nga 1 000 (një mijë) deri në 5000(njëzetmijë) lekë**
5. Për kundërvajtjen *njësitë e shitjes ambulatorë pranë institucioneve publike*; **Policia Bashkiake vendosë gjobë nga 1 000 (një mijë) deri në 5000(njëzetmijë) lekë**
6. Për kundërvajtjen *shkelja e distancës midis dy shitjeve ambulatorë prej 30 m* **Policia Bashkiake vendosë gjobë nga 1 000 (një mijë) deri në 5000(njëzetmijë) lekë**
7. Për kundërvajtjen *shkelje e pikës f), g), j), k) të nenit 39*, **Policia Bashkiake vendosë gjobë nga 1000 (një mijë) deri në 20000(njëzetmijë) lekë**

C- Masat e sanksionimit me gjobë për kundërvajtjet administrative të parashikuara në nenin 23 të kësaj rregullore janë

1. Për kundërvajtjen *vendosja e pedanave, shtrojeve dhe tapeteve në trotuare publik, që mbartin vlera artistike dhe ambientale* **Policia Bashkiake vendosë gjobë nga 1 000 (një mijë) deri në 5000 (njëzetmijë) lekë**
2. Për kundërvajtjen *mbulimi i kapakëve të pusetave, rrjetave të ajrimit dhe të tjera të ngjashme me to, prerja dhe ngjeshja e rrënjëve që dalin mbi sipërfaqe, apo cdo dëmtim dhe prishje trotuari* **Policia Bashkiake vendosë gjobë nga 1 000 (një mijë) deri në 5000 (njëzetmijë) lekë**

D- Masat e sanksionimit me gjobë për kundërvajtjet administrative të parashikuara në nenin 53 të kësaj rregullore janë

1. Për kundërvajtjen *Eksponon mallra të ndryshëm nga ato të përcaktuar në lejen me të cilën është pajisur*; **Policia Bashkiake vendosë gjobë nga 1 000 (një mijë) deri në 5000(njëzetmijë) lekë**
2. Për kundërvajtjen *Aktiviteti është mbyllur dhe ai nuk ka larguar pajisjet nga zona* **Policia Bashkiake vendosë gjobë nga 1 000 (një mijë) deri në 5000(njëzetmijë) lekë**

E- Masat e sanksionimit me gjobë për kundërvajtjet administrative të parashikuara në nenin 16 të kësaj rregullore janë:

- Për kundërvajtjen vendosje e
- a) Tavolina;
 - b) Tenda me strehë;
 - c) Tenda diellore;
 - d) Tenda me bimë kacavjerrëse;
 - e) Çadra dielli;
 - f) Saksi dhe elementë kufizues;
 - g) Pedana dhe tapete;

- h)** Erëprisë;
- i)** Lojëra për fëmijë

në hapësirat publike pa u pajisur me lëjën përkatëse **Policia Bashkiake vendos gjobë nga 1 000 (një mijë) deri në 5000(njëzetmijë) lekë ose IMT vendos gjobën në masën e specifikuar në ligjin 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin territorit” (i ndryshuar);, sipa llojit të kundrvajtjes.**

F- Shpërblimi i dëmit dhe përlogaritja e tij

1. Nëse struktura konstatuese, konstaton shkaktim dëmi që vjen si pasoj e kundërvajtjes administrative, menjëherë pas vendosjes së gjobës për kundërvajtjen administrative, njofton strukturën përkatëse që është përgjegjëse për përlogaritjen e dëmit të shkaktuar dhe dëmshpërblimin e tij.
2. Struktura përgjegjëse vlerëson masën e dëmit dhe me një akt administrativ më vete vendos masën dhe mënyrën e shpërblimit të dëmit.
3. Shpërblimi i dëmit kryhet nëpërmjet zëvendësimit apo kthimit në gjendjen e mëparshme të pronës publike, sendit/objektit/hapësirës së dëmtuar ose duke paguar kundërvleftën monetare të dëmit të shkaktuar.
4. Vlera e dëmit të llogaritet sipas kundrvajtjes , por asnjëherë jo më pak se vlera për tu kthyer në gjenjen e mëparshme.
5. Struktura përgjegjëse për shqyrtimin përlogaritjen e dëmit është Sektori i mjedisit dhe konsumatorit , Sektori i shërbimeve, drejtoria e planifikimit,drejtoria e bujqësisë dhe gjithë sektorët sipas llojit dhe fushës ku është kundrvajtja.

G-Mënyra e caktimit të dënimit

1. Sanksioni administrativ që zbatohet për çdo shkelje caktohet duke respektuar parimin e proporcionalitetit në raport me shkeljen e konstatuar, dispozitat e ligjit për kundërvajtjet administrative mbi kriteret për caktimin e llojit dhe masës së dënimit, si dhe dispozitat e këtij vendimi.
2. Nëse personi fizik ose personi juridik ka kryer më shumë se një kundërvajtje nga ato të parashikuara nga ky vendim, si dhe çdo akt tjetër ligjor e nënligjor, dënimi jepet për çdo kundërvajtje.
3. Në rastin kur disa kundërvajtje të kryera nga i njëjti person, konstatohen dhe shqyrtohen nëpërmjet të njëjtit procesverbal, caktohet një dënim me gjobë që përbëhet nga bashkimi i dënimeve me gjobë për secilin nga kundërvajtjet por jo më shumë se dyfishi i masës së gjobës së parashikuar për kundërvajtjen më të rëndë.
4. Nëse në kryerjen e kundërvajtjes kanë marrë pjesë më shumë se një person, dënimi jepet në mënyrë të veçantë për secilin kundërvajtës.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA URA VAJGURE

Nr _____ Prot

Urë Vajgurore me ____/____/2020

PROCES - VERBAL

Për konstatimin e kundravajtjes administrative

Nr. _____ prot., datë ____/____/2020

Mbështetur në ligjin nr.10279, datë 20.05.2010 "Për kundravajtje administrative", në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. _____ datë ____/____/2020, hartohet proces - verbali për konstatim të kundravajtjes administrative në prezence të:

Struktura administrativ përgjegjëse _____

Përfaqësuar nga :

1. _____

2. _____

Kundravajtësi

Qytetari _____ Adresa:Lagjia: _____

Rruga _____

Personi fizik/juridik _____ Pronari _____

Kundravajtja Administrative e konstatuar: _____

Struktura administrative përgjegjëse

1. _____

2. _____

Të pranishëm

Kundravajtësi

(_____)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA URA VAJGURORE

VENDIM

Për dënimin me gjobë për kundravajtjen administrative

Nr. _____ prot. , datë ____/____/2020

Mbështetur në ligjin nr.10279 datë 20.05.2010 "Për kundravajtje administrative" , në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. ____ datë ____/____/ 2020 dhe në Proces verbalin e konstatimit nr____prot. datë ____/____/____

Vendosa:

1.Dënimin me gjobë në masën _____(me fjalë) për kundravajtjen

mbështetur në Kreun __ , pikën __ , gërma _____në aneksin 2 të vendimit të Këshillit Bashkiak nr. ____ datë ____/____/ 2020 , konstatuar në proces verbalin e konstatimit nr____ prot. datë ____/____/____ kryer nga kundravajtësi _____, në fshatin / lagjen /rrugën _____

2.Arkëtimi i gjobës duhet të bëhet brenda 24 orëve nga njoftimi. Për të kryer pagesën duhet të paraqiteni për tërheqjen e faturës së arkëtimit në drejtorinë e tatim taksave dhe menazhimin e aseteve .

3.Për mospagimin në afat të gjobës, llogaritet kamat 1% te vleres për cdo ditë vonese .

4. Ky vendim I dërgohet kundravajtësit me njoftimin nr. _____prot. datë ____/____/____ me postë .

Struktura administrative